



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Në mbështetje të nenit 32 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 5 të Rregullores Nr. 13/2023 për Zëvendësimin apo Mungesën e Përkohshme nga puna e Nëpunësit Civil, si dhe nenit 7 të Rregullores Nr. 05/2022 për procedurat Konkurruese dhe Pranim për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, shpall:

KONKURS ME AFAT TË CAKTUAR

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale: Kërkon të punësojë në Departamentin e Gjeologjisë.

Titulli i vendit të punës: Gjeolog i Lartë-Hartograf - 1(një) pozitë

Klasa / koeficienti: Specialist / 7

Numri i referencës së vendit të punës: 001/07/2023

1. Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përpilimin e hartave gjeologjike dhe Gjeo-shkencore të Kosovës,
- Ndihmë në vlerësimin e raporteve Gjeo-shkencore, përfshirë raportet për projekte të hulumtimeve dhe të shfrytëzimeve,
- Mbikëqyrje dhe ndërmarrje të punëve në teren për përvetësimin e të dhënave të reja gjeologjike, përpilimin e raporteve Gjeo-shkencore sipas kërkesës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale,
- Të kryen vizita në teren qoftë në miniera nëntokësorë apo sipërfaqësore në lidhje me shqyrtimin e aplikacionet për; Hulumtim, shfrytëzim, transfer, vazhdim etj,
- Monitorimin e aktiviteteve të hulumtimit,
- Detyra tjera kohë pas kohe sipas kërkesave të Shefit të Gjeologjisë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret – të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe.

2. Shkollimi, aftësia, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

- Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve (në Gjeologji). Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës. Përvoja e punës, përveç vërtetimit të punësimit duhet dëshmuar edhe me pasqyrën e llogarisë nga Trusti ose Rregullores në fuqi.
- Shkallë të lartë të integritetit, iniciativës dhe aftësi për të punuar nën presion,
- Zotimi për përshtatjen zhvillimeve legjislative dhe nevojave në sektorin relevant,
- Aftësi të shkëlqyeshme me kompjuter, aftësi në të shkruar dhe në të folur Shqip, Serbisht, dhe Anglisht,
- Aftësi dhe gatishmëri të demonstruar për të punuar në mjedis multietnik, trajnime, plotësuese lidhur me hartat gjeologjike,
- Njohuri standarde në punë me kompjuter, aftësi të krijoj raporte, duke punuar para përfundimit të afateve.

3. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

Kushtet e pjesëmarrje në rekrutim:

- Pranimi në shërbimin civil në pozitat e jokarrierës është i hapur për të gjithë.

Zbatimi i parimeve të punës:

- Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publik, dhe parimet specifike të punës.

Kohëzgjatja e angazhimit: Me afat të caktuar, pozitë jo e karrierës

- Një (1) pozitë – deri në dymbëdhjetë (12) muaj

Paraqitja e aplikacioneve në adresen:

Komisioni i Pavarur për Minerë dhe Minerale

Rr. Armend Daci Nr.1

10 000 Prishtinë, Kosovë

E-mail: icmm@kosovo-mining.org

Web: www.kosovo-mining.org

Data e njoftimit: 20.07.2023

Afati për aplikim: 28.07.2023-04.08.2023

Formulari për aplikim mund të shkarkohet në uebfaqen e KPMM-së:

Në linkun <http://kosovo-mining.org/>

Dokumentet që duhet të bashkëngjiten aplikacionit:

Letër motivimi / CV

Dokumenti i identifikimit

Dëshmitë e kualifikimeve arsimore

Dëshmia mbi përvojën e punës

Letër-rekomandimet

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Për informata plotësuese ju mund ta kontaktoni Zyrën e Personelit në:

Nr. i telefonit 038 240 252 203, ose mund të dërgoni email: icmm@kosovo-minig.org.